




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/ 316
20/12/2018
Podujevë

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i datës 19.10.2017, Drejtoria e Arsimit shpallë:

Konkurs për plotësimin e vendeve të punës

Pozita:

- **Roje nate (një pozitë)**
- **Punëtor teknik – pastrues (dy pozita)**

Vendi i punës:

- Një roje nate në shfmu “Dr. Ibrahim Rugova” Podujevë,
- Një punëtor teknik – pastrues në shfmu “Shefki Kuleta” paralelja e ndarë në Halabak,
- Një punëtor teknik – pastrues në shfmu “Ali Hadri” paralelja e ndarë në Katunishtë.

Detyrat kryesore të punës

- **Pozita roje e natës:**
 - Regjistrohet në ditarin e punës,
 - Përkujdeset për sigurinë e ndërtesës së shkollës, përfshirë edhe oborrin,
 - Mbikëqyrë hyrjet dhe daljet në objekt,
 - Bën kontrollimin e objektit dhe rreth tij,
 - Kryen edhe detyra tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.
- **Pozita punëtor teknik – pastrues:**
 - Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha mjediset e shkollës, të mirëmbajë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës;
 - Të ruaj mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujës;
 - Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës;
 - Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lëndëve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe sipas nevojës, t’ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës;
 - Të përkujdeset për sanimin, mirëmbajtjen e inventarit të shkollës dhe për sanimin e prishjeve teknike në objektin e shkollës;
 - Kryen edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm (të dorëzojnë dëshmi mbi kualifikimin),
- Certifikatën e lindjes,
- Dokumentin personal – letërnjoftimin ose pasaportën (kopje),
- Dëshmi që nuk jeni të ndjekur penalisht,
- Të kenë shëndet të mirë,

- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranohen në marrëdhënie pune, para se të lidhet kontrata),
- Dokumentet nuk kthehen,
- Formulari i aplikimit (merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra nr. 14).

Afati i konkursit:

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike, nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, deri më datë 04/01/2019.

Drejtori

Agim Blakçori, MSc.

